



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:276522

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05808074

2022:019530

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, me gjyqtaren e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me zyrtarin ligjor Ymri Ibrahim, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.Gj, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.1801/21 të datës 31.01.2022, në praninë e prokurorit të shtetit Mimoza Sylja Hyseni, të akuzuarit B.Gj me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare av. Xhemajl Ahmeti, dhe përkthyesit të gjykatës Fadil Qorrolli pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datës. 22.05.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse me datë 11.06.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.GJ, me nofkën "C..", nga i ati Z.., e ëma R.. e gjinisë S., i lindur me datës.... në Prishtinë, me vendbanim në G.., ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, me profesion ekonomist, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i dy fëmijëve, punon në Institutin e personave me nevoja të veçanta, serb, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal 11...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 22.11.2021 rreth orës 14:00,në Ferizaj, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten, përmes paraqitjes të fakteve rreme, në mënyrë mashtruese ka vënë në lajthim të dëmtuarin S.S., në atë mënyrë që ka bërë manipulimin e kilometrave në automjetin e markës “P.” 308, ngjyrë e bardhë me nr. të targave 0..., dhe me nr. të shasisë V..., duke ndryshuar kilometrat e veturës nga 188624 km sa kishte fillimisht kur i është bërë kontrolli teknik veturës në QKTA “E.” SH.P.K me datën 20.02.2020, në 152118 km të ndryshuara, të vërtetuara në kontrollin teknik të veturës të bërë në “...” SH.P.K me datën.26.02.2021, dhe të njëjtin automjet ia ka shitur të dëmtuarit S.S.,

me këtë ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 53, 69 dhe 70 të KPRK-së si dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarin e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës kohore prej një (1) viti pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Me dënim me gjobë në shumën prej dyqindpesëdhjetë (250) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, i njëjti në pajtim me nenin 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që një ditë burgim do të jetë ekuivalente me njëzet (20) euro gjobë të pa paguara.

I dëmtuari S.S. me vendbanim në Ferizaj, rruga “...” për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej njëzetë

(20) euro, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.1801/21 të datës 31.01.2022 e ka ngarkuar të akuzuarin B.Gj, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 22.05.2024, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin prokurori i shtetit Mimoza Sylja Hyseni, i akuzuari B.Gj dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av. Xhemajl Ahmeti.

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 22.05.2024, pasi që gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 319 par. 1 dhe par.2 të KPPK-së dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit. Pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, konform nenit 321 par.1 të KPPK-së i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari B.Gj me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në fillimi të shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saj, se është i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se pranimin e fajësisë e bënë në shenjë pendimi për veprën të kryer.

Meqë i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 322 par. 1 të KPPK-së ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 242 par.2 të KPPK-së: i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: raporti

i oficerit të datës.22.11.2021, deklaratat e të dëmtuarit të dhënë në polici 14.07.2021 dhe datës.28.01.2022, deklarata e dëshmitarit A.XH të dhënë në polici 18.08.2021 , deklarata e dëshmitarit B.S të dhënë të dhënë në polici me datës.24.08.2021, polica e sigurimit e datës.21.02.2020, fatura e auto sallonit “...”, “NTP” e datës.20.02.2020, kontratat për shitblerjen e automjetit e datës. 15.09.2020 me nr, LRP.6../2020, ref.1../2020, librezë e automjetit “Pe.t” me numër identifikues VF...4...1 kopje, shkresa nga kontrolli teknik QKTA-ja “LLC C.” SH.P.K. e datës . 26.02.2020, dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë.

Fjala përfundimtare e palëve

Pasi që gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, konform nenit 350 të KPPK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Mimoza Sylja Hyseni në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, me këtë vërtetohet gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës dhe se kjo ka mbështetje edhe në shkresat e lëndës, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit duke i propozuar gjykatës që si rrethanë rënduese të marrë parasysh intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, ndërsa si rrethanë lehtësuese të marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të akuzuarit, av. Xhemajl Ahmeti në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që si rrethanë lehtësuese të marrë faktin se i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprën e kryer, ka shpreh keqardhje për këtë vepër penale, sjelljen e tij korrekte me gjykatën si dhe gjendjen e dobët ekonomike.

I akuzuari B.Gj në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se është penduar thellë, ka shprehur keqardhje dhe ka kërkuar falje publike, ka deklaruar se është mbajtës i familjes, ka premtuar se nuk do të përsërisë më vepra të tilla penale, si dhe e ka lutur gjykatën që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe t’i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Të gjeturat e gjykatës, matja dhe shqiptimi i dënimit

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, faktin se i akuzuari është mbajtës i familjes, baba i dy fëmijëve, gjendjen e dobët ekonomike, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe peshën e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Prandaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil është marrë konform nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 452 paragrafi 1 lidhur me nenin 449 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
2022:019530 me datë 11.06.2024.

Zyrtari Ligjor

Gjyqtarja e vetme gjyqësore

Ymri Ibrahim

Hakile Ilazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në kopje të mjaftueshme në Gjykatën Themelore në Ferizaj.